



ÇFARË KEMI MBJELLË, E ÇFARË PO KORRIM?

Analizë e Strategjisë nacionale për rrjetëzimin,
bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes
të kuadrove me arsim të lartë dhe
profesional 2013 - 2020



IMPRESUM

Titulli:

Çfarë kemi mbjellë, e çfarë po korrим?
Analizë e Strategjisë nacionale për rrjetëzimin,
bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të
kuadrove me arsim të lartë dhe profesional 2013 - 2020

Autorë:

Mila Karadafova
Oliver Andreevski

Botues:

Rrjeti për parandalimin e derdhjes të trurëve

Disajni:

Kiril Pajmakoski

Shtypi:

Polyesterday

Tirazh:

200 ekzemplar

Mbështetur nga :



Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e botuesit dhe autorit dhe nuk i pasqyron pikëpamjet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedoni.

PËRMBAJTJA

01

Hyrje në analizën
-Metodologjia

03

Hyrje në analizën
-Për projektin

04

Hyrje në analizën
-Gjetjet kryesore

07

Analiza e strategjisë nacionale për rrjetëzimin,
bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të
kuadrove me arsim të lartë dhe
profesional 2013-2020

08

Analiza
-Pjesa 1 / Objektivi strategjik 1

10

Analiza
-Pjesa 1 / Objektivi strategjik 2

12

Analiza
-Pjesa 1 / Objektivi strategjik 3

14

Analiza
-Pjesa 1 / Objektivi strategjik 4

16

Analiza
-Konkludimi

17

Analiza
-Objektivi Strategjike

18

Analiza
Pjesa 2 / Ndikimi i strategjisë

21

Analiza
-Pjesa 2 / Njoftimi me strategjinë nga personat që e kanë poltësuar anketën

26

Analiza
-Pjesa 2 / Njoftimi me strategjinë e personave të rinj me të cilit është realizuar intervista

29

Analiza
-Rekomandime

32

Rekomandime
-Opinionet e të rinjve që jetojnë në vendin tonë

34

Rekomandime
-Adresimi i sfidave dhe planifikimi strategjik

36

Rekomandime
-Parametrat joekonomike



HYRJE NË ANALIZËN

Për të përcaktuar nivelin e zbatimit të Strategjisë nacionale për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional 2013 -2020 (në tekstin e mëtejme Strategjia) është zhvilluar një qasje metodologjike me tre objektiva specifike. Objektivi i parë ishte përcaktimi i nivelit të përgjithshëm të zbatueshmërisë së strategjisë. Objektivi i dytë ishte të shihet ndikimi i mundshëm i vetë aktiviteteve të parashikuara në strategji. Objektivi përfundimtar ishte të jepen orientime me rekomandime për institucionet përkatëse.

Për të përcaktuar nivelin e zbatueshmërisë së Strategjisë, u realizuan intervista të thella me institucionet e interesuara të parashikuara në Strategji. Struktura e intervistave u përcaktua sipas qëllimeve dhe masave strategjike në këtë Strategji, varësisht nga detyrimet e parashikuara për këtë institucion. Informacionet mbi aktivitetet që u përshkruan në mënyrë specifike u kërkuan përmes kërkesave për qasje në informacione me karakter publik.



Të dhënat e mbledhura u përfshinë në një matricë me qëllim për sistematizimin, indeksimin dhe kuantifikimin e tyre. Çdo aktivitet u vlerësua në bazë të tre niveleve të përmbushjes, të papërmbushura (0), pjesërisht të përmbushura (1) dhe tërësisht të përmbushura (2). Për secilin aktivitet, është parashikuar një faktor peshues me qëllim për të rritur vlefshmërinë e rezultateve. Faktori peshues përcaktohet sipas katër kriterëve: institucionet e përfshira, rinia e përfshirë nga vendi, rinia e përfshirë nga jashtë dhe faktorët të përfshirë për zbatimin e aktivitetit.[1] Pastaj, sipas vlerësimit për secilën nga aktivitetet, përlllogaritet vlerësimi mesatar për masën strategjike e cila më pas shumëzohet me lartësinë e faktorit peshues, me ç'rast fitohet koeficienti përfundimtar i përmbushjes për secilën nga masat dhe më pas edhe niveli i zbatimit të objektivit strategjik.

Për të vlerësuar ndikimin e Strategjisë, u realizuan intervista të thella me të rinj të fushave deficitare që jetojnë në vend dhe të rinj që kishin emigruar. Për më tepër, është zbatuar edhe një studim publik për të marrë një sasi më të madhe të dhënave mbi ndikimin e strategjisë.

Dy metoda janë përdorur për të krijuar rekomandime. Së pari, në bazë të intervistave të thella dhe kërkesave për informacione me karakter publik janë identifikuar mangësi dhe sfida me të cilat përballen institucionet gjatë zbatimit të Strategjisë. Në këtë pjesë është përpiluar edhe një pyetësor i veçantë për institucionet përkatëse mbi sfidat të cilat adresohen në procesin e planifikimit strategjik në tërësi. Së dyti, përmes pyetjeve të drejtpërdrejta që u janë adresuar të rinjve përmes intervistave të thella dhe sondazhit publik për atë çka konsiderojnë ata se mungon në Strategjinë aktuale, por edhe si të rimendohet qasja e përgjithshme për këtë problem.



PËR PROJEKTIN

Kjo analizë është përgatitur si pjesë e projektit "Rrjeti për parandalimin e derdhjes të trurëve" i financuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni. Qëllimi i projektit është të krijojë një mjedis mbështetës për vetë-realizimin e të rinjve nga Maqedonia e Veriut dhe ndaljen e potencialit të tyre në vend.

Përmes tij në do të përpiqemi t'a rrisim vetëdijen e publikut për problemin me derdhjen e trurëve, por gjithashtu do t'i përfaqësojmë masat dhe politikat para institucioneve që mendojmë se janë të nevojshme për të zvogëluar mërgimin.

Përveç kësaj analize, projekti përfshinë, gjithashtu, edhe zbatimin e tryezave të rrumbullakëta dhe hartimin e një dokumenti për politika që do të gjenerojë rekomandime, si dhe organizimin e një konference nacionale për parandalimin e derdhjes të trurëve në Maqedoninë e Veriut.

PËR RRJETIN

Rrjeti për parandalimin e derdhjes të trurëve është një rrjet joformal i 7 organizatave civile që punojnë në fusha të ndryshme që lidhen me zhvillimin e të rinjve, politikat dhe të drejtat e të rinjve, si dhe informimin rinor.

Qëllimi i Rrjetit është të rritet vetëdija tek institucionet dhe qytetarët për largimin e të rinjve nga vendi, si dhe të propozojë masa dhe zgjidhje për të parandaluar këtë fenomen.

Anëtarët e Rrjetit për parandalimin e derdhjes të trurëve janë: Shoqata Liderë për edukim, aktivizim dhe zhvillim, Asociacioni për edukim Mlladiinfo Internacional, Shoqata e qytetarëve Të rinjtë munden, Shoqata rinore-Krushevë, Shoqata për disleksi Ajnshtajn, Qendra për aktivizëm rinor KRIK, Qendra për zhvillimin multidisiplinar CMR PROCES.



Analiza e strategjisë tregoi se përqindja e implementimit e të njëjtës në këtë periudhë 7 vjeçare është shumë e ulët , ose 11%. Nisur nga ky fakt, përfundimi kryesor është se e njëjta nuk është prioritet i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës si institucion kompetent dhe institucionet e tjera.

GJETJET KRYESORE

Përqindja e përmbushjes së Strategjisë

■ Papërmbushur
■ Përmbushur




Përqindja e përmbushjes në bazë të fushave strategjike




Nëse shikojmë më në detaje në katër qëllimet strategjike të Strategjisë, do të vërejmë se aktivitetet e parashikuara janë ose shumë pak ose nuk janë implementuar fare. Ky fakt nuk është befasesues, pasi që për këtë strategji është miratuar vetëm një plan veprimi në vitin 2014.

Prandaj , informimi i të rinjve që jetojnë dhe janë shpërngulur jashtë vendit me këtë Strategji është shumë i vogël, që është në përpjesëtim me mos realizimin e saj dhe mungesën e aktiviteteve për të.

Informimi i të rinjve që jetojnë në Maqedoninë e Veriut me këtë Strategji




Informimi i të rinjve që janë shpërngulur nga shteti me këtë Strategji




Një fushë tjetër që është një pjesë e rëndësishme e Strategjisë është se si shteti bashkëpunon me kuadrot me arsim të lartë që janë shpërngulur. Këtu, mërgimtarët në pjesën më të madhe konsiderojnë se shteti nuk po i përdor potencialet e tyre (62%) ose nuk janë të informuar për këtë (24%). Vetëm 6% konsiderojnë se potencialet janë përdorur në një farë mënyre.

Institucionet shtetërore në Maqedoni, përmes bashkëpunimit, i përdorin potencialet e mërgimtarëve me kualifikim të lartë



Për më tepër, një gjetje tjetër e rëndësishme janë rekomandimet e të rinjve që jetojnë në vend që kanë prirje të shpërngulen nga njëra anë, dhe ata që tanimë janë shpërngulur në anën tjetër. Të dy grupet e synuara identifikuan fusha pothuajse identike në të cilat është e nevojshme të bëhen reforma për të parandaluar shpërnguljen. Ata janë:



Brenda këtyre fushave, propozohen rekomandime që, para se gjithash, do të mundësojnë që të rinjtë të vendosen më mirë në tregun e punës, të rriten mundësitë për zhvillimin e karrierës, por edhe për ndërtimin e aftësive. Në fushën e arsimit nënvizohet se ka nevojë për modernizimin e tij dhe më shumë mundësi për kërkime dhe trajnime gjatë procesit arsimor. Ndërsa, në fushën e komunikimit ndërinstitucional, është nënvizuar bashkëpunimi më i madh i institucioneve me të rinjtë dhe përfshirja e tyre në planifikimin dhe realizimin e masave.

ANALIZA E STRATEGJISË NACIONALË PËR RR-JETËZIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE ZVOGËLIMIN E DERDHJES TË KUADROVE ME ARSIMIM TË LARTË DHE PROFESIONAL 2013-2020

Strategjia nacionale për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional është përgatitur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe është miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2013. E njëjta është e vlefshme deri në vitin 2020. Deri më tani është përpiluar vetëm një Plan i veprimit në vitin 2014.

Për të identifikuar nivelin e zbatueshmërisë të Strategjisë, u realizua një hulumtim i plotë.

Në periudhën nëntor-dhjetor 2019 janë realizuar 4 intervista me udhëheqës ose zëvendës-udhëheqës të departamenteve:

1

Departamenti për Arsimin e Lartë

2

Departamenti për Bashkëpunimin Ndërkombëtar

3

Departamenti për Planifikimin dhe Analizën Strategjike

4

Departamenti për Shkencë dhe Inovacione

nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Intervistë u realizua me drejtorin e Agjencisë për emigracionin të Republikës së Maqedonisë së Veriut si palë e listuar e interesuar në zbatimin e Strategjisë. Si burim i informacioneve u paraqitën kërkesa për informacione me karakter publik në Sekretariatit për Çështje Evropiane, Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratën, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, Ministrinë e Ekonomisë dhe Agjencinë "Invest in Macedonia".

Për zbulimin e përmbushjes përfundimtare të masave u kryqëzuan të dhënat e fituara nga intervistat dhe informacionet me karakter publik, të faktorit peshues dhe të dhënat dytësore.

Faktori peshues është përfshirë me vetë analizën për të përcaktuar në mënyrë sasiore dhe cilësore peshën e zbatimit të masës.



OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

Objektivi Strategjik Nr.1 i Strategjisë nacionale për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional 2013-2020 thotë:

"Krijimi i një sistemi nacional për administrimin me lëvizjen e individëve me arsim të lartë nga vendi dhe aktivizimi zhvillimor i potencialeve të emigracionit intelektual."

Sipas analizës të dhënave të marra përmes intervistave dhe informacioneve publike, si dhe të dhënave dytësore, zbatimi i përgjithshëm i qëllimit strategjik është 4%.

Në këtë objektiv strategjik janë numëruar 4 masa që përmbajnë aktivitete për përm-bushjen e të njëjtës. Në zbatimin e analizës, aktivitetet në bazë të Planit të Veprimit për periudhën 2013 - 2014, të miratuar në 2013, janë marrë si tregues për zbatimin e objektivit strategjik, duke pasur parasysh që ky Plan veprimi është i vetmi ekzistues për zbatimin e Strategjisë.

Masat që janë renditur me objektivin strategjik 1 janë:

1. "Themelimi i një grupi të përbashkët pune (njësia e projektit) nga të gjitha institucionet dhe organizatat për administrimin dhe kujdesin për emigracionin intelektual"

Në këtë masë, sipas këtij plani të veprimit, janë planifikuar dy aktivitete për të formuar një grup pune dhe për të krijuar një plan veprimi për vitin 2015.

Sipas intervistave të zbatuara me institucionet, nga aktivitetet është përm-bushur pjesërisht njëri nga aktivitetet, gjegjësisht është krijuar një plan i veprimit nga viti 2013. Në krijimin e këtij plani të veprimit ka marrë pjesë vetëm Ministria e Arsimit dhe Shkencës, mbasi një grup pune funksional nuk ishte formuar fare, kurse edhe vetë ministria është institucioni përgjegjës për zbatimin e kësaj mase.



2. Sistemi funksional për monitorimin dhe menaxhimin më të lehtë me emigracionin intelektual në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Nga kjo masë rezultojnë dy aktivitete për analizën e qëndrimeve dhe mbështetje për integrimin e të kthyerve (emigracioni intelektual) në vendin tonë. Nga aktivitetet e planifikuara, vetëm mbështetja për kthimin e emigracionit intelektual në vend është përmbushur pjesërisht. Gjegjesisht, studentët që janë financuar nga shteti janë të detyruar të kthehen në vend dhe të qëndrojnë për një periudhë të caktuar kohe, kurse shteti duhet t'u sigurojë atyre një vend punë. Edhe pse nuk është përfshirë në planin e veprimit, ky aktivitet, megjithatë, në mënyrë indirekte kontribuon në përmbushjen e masës. Për këtë masë, institucioni përgjegjës për zbatimin e saj është Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngjarje promovuese jashtë vendit për të afirmuar politikën për zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional dhe për të organizuar "Forumin e ekspertëve maqedonas jashtë vendit".

Kjo masë përfshin aktivitete për organizimin e "Forumit të Ekspertëve Maqedonas Jashtë vendit". Krijimi i programit, seleksionimi i target tregjeve dhe zbatimi i programit, me një ngjarje përfundimtare - forumin. Ekipi që punonte në këtë analizë nuk arriti të gjente informacione mbi zbatimin e mundshëm të aktiviteteve nga kjo masë, duke përdorur të gjitha mjetet e përmendura në pjesën hyrëse. Institucioni përgjegjës për zbatimin e kësaj mase është Agjensia "Invest in Macedonia".

4. Gjallërimi i opinionit publik përmes emisioneve / artikujve në media, ku do të prezantohen përfaqësuesit e emigracionit maqedonas.

Aktivitetet në këtë masë synojnë përcaktimin e aksesit, përzgjedhjen e mediave dhe krijimin e përmbajtjes së mediave për të gjallëruar opinionin publik dhe për të prezantuar më tej përmbajtjet sipas një plani të përcaktuar. Sipas informacioneve të mbledhura, aktivitetet janë tërësisht të papërmbushura. Për zbatimin e aktiviteteve nga kjo masë, si institucion përgjegjës është përcaktuar Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2

Objektivi strategjik Nr. 2 i Strategjisë nacionale për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional 2013-2020, thotë:

” Zvogëlimi i derdhjes të trurëve përmes rritjes të atraktivitetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si një vend punësimi dhe angazhimi i personave të rinj me arsim të lartë.”

Sipas të dhënave të marra nga intervistat e kryera, informacionet me karakter publik, si dhe të dhënave dytësore, zbatimi i përgjithshëm i Objektivit strategjik nr.2 është 9%

Në këtë objektivi strategjik janë përfshirë 4 masa, kurse përmes aktiviteteve të përcaktuara në planin e vetëm të veprimit dhe zbatueshmërinë e tyre, arrihet një rezultat individual për përmbushjen e secilës masë dhe objektivin e përgjithshëm strategjik.

Masat që përfshihen në objektivin strategjik nr. 2, janë:

1. "Mbështetja e pjesëmarrjes të sektorit privat në zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë"

Në këtë masë, sipas planit të veprimit, është përfshirë vetëm një aktivitet, edhe atë analizimi i nevojave dhe mundësive të sektorit privat. Nuk ka asnjë informacion mbi këtë aktivitet, kurse nga vetë institucionet përgjegjja është se nuk ka informacion. Sipas të dhënave dytësore, nuk ka gjithashtu asnjë informacion mbi zbatimin e mundshëm të aktivitetit. Institucioni përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve nga kjo masë është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

2. "Forcimi i kompetencave të administratës publike në përputhje me tendencat e reja të punës"

Kjo masë, si dhe ajo e mëparshmeja, përfshin një veprimtari sipas Planit të Veprimit - Përgatitja e një plani pune për ndryshimin e sistematizmit në institucionet publike / shtetërore. Sipas informacioneve të marra, ky aktivitet nuk është përmbushur. Institucioni përgjegjës për zbatimin e kësaj mase është Ministria e Shoqërisë Informative dhe Administratës.

3. "Optimizimi i vëllimit dhe numrit të profileve arsimore të universiteteve të financuara nga shteti, konform mundësive dhe nevojave të RM-së"

Kjo masë përfshin 3 aktivitete të cilët sipas planit të veprimit janë në kompetencën e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Aktivitetet përfshijnë vlerësimin e nevojave, përgatitjen e konkursit dhe zbatimin e konkursit me pjesëmarrjen e universiteteve në vend. Sipas informacioneve të marra, vetëm një nga 3 aktivitetet e planifikuara është zbatuar plotësisht, d.m.th. vlerësimi i nevojave dhe mundësive, ndërsa për dy të tjerët nuk ka asnjë informacion nga institucionet për zbatimin e tyre. Bashkëbiseduesi ynë i ministrisë tha se "aktiviteti është bërë në mënyrë indirekte përmes Ligjit për arsimin e lartë. Ekziston një organ i themeluar, bordi për besimin dhe bashkëpunimin me publikun. Ky bord merr vendime për numrin e kuotave për regjistrimin në institucionet e arsimit të lartë konform shkallës së papunësisë në profesione të caktuara".

4. "Ngritja e nivelit të cilësisë të të gjithë sistemit arsimor në vend si dhe rrjetëzimi i arsimit të lartë në institucionet të arsimit të lartë ku punojnë studiues me origjinë nga Maqedonia"

Kjo masë përfshin 3 aktivitete. Aktivitetet përfshijnë pjesëmarrjen e stafit të mësimdhënësve dhe stafit administrativ nga universitetet në mobilitetet nisëse dhe ngritjen e vetëdijes dhe njohurive për projekte kërkimore shkencore, si dhe pjesëmarrjen dhe zbatimin e aktiviteteve me rrjetëzime tematike dhe shoqata

shkencore për kërkime dhe organizata kërkimore. Sipas informacioneve të marra, të tre aktivitetet janë përmbushur pjesërisht sipas treguesve të caktuar dhe informacioneve nga plani i veprimit. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtyre veprimtarive janë Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Agjencia Kombëtare e Programeve dhe Mobilitetit të Arsimit Evropian. Sipas bashkëbiseduesve tanë, "kanë ekzistuar dispozita në ligjin për vizitat studimore, por disa nga dispozitat janë shfuqizuar. Ekziston mobilitet (lëvizshmëri) të stafiit mësimdhënës dhe stafit administrativ nga universitetet, por ata duhet vetë t'i gjejnë këto mundësi, mbasi nuk sigurohet nga shteti. universitetet vendosin vetë nëse do të përfshihen në projekte të caktuara. Një shembull është Programi "Horizont 2020" - Programi Kornizë i Kërkimit dhe Inovacionit (2014-2020) për të cilin MASH ka nënshkruar një marrëveshje."

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

CObjektivi strategjik Nr.3 i Strategjisë nacionale për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e kuadrove me arsim të lartë 2013 – 2020, thotë:

„Kalimi nga një derdhje në një prurje të kuadrit me arsim të lartë përmes rritjes të nivelit dhe vëllimit të kthimit të emigracionit intelektual nga Republika e Maqedonisë dhe rritjes së vetëdijes për zhvillimin e kapitalit njerëzor“

Nga informacionet e marra nga zbatimi i analizës, përmbushja e përgjithshme e këtij objektiv strategjik është 7%.

Ashtu si edhe në dy objektivat e mëparshme, edhe në këtë objektiv strategjik, ekzistojnë 4 masa për ta realizuar të njëjtën. Ky objektiv strategjik përfshin masat e mëposhtme:

1. "Angazhimi profesional i përfaqësuesve të emigracionit intelektual në sektorin privat maqedonas"

Kjo masë përfshin 4 aktivitete, kurse si institucion përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve është caktuar Ministria e Ekonomisë. Këto aktivitete përfshijnë zbatimin e analizës së nevojave, përgatitjen e programeve, përzgjedhjen e ndërmarrjeve dhe dhënien e subvencioneve mërgimtarëve që posedojnë aftësi dhe njohuri për sigurimin e mbështetjes teknike për kompanitë në vend. Sipas të gjitha informacioneve të kërkuara përmes instrumenteve në këtë analizë nuk kemi marrë informacione për zbatimin e tyre, kurse sipas të dhënave dytësore aktivitetet në këtë masë nuk janë përmbushur.

2. "Bursimi i studentëve vendas nga investuesit e huaj"

Kjo masë përfshin 3 aktivitete dhe zbatohet plotësisht nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Përmes përgatites të një plani për punë dhe nxitjen e investuesve të huaj, përgatitet një listë për kompanitë e huaja dhe për organizimin e takimeve. Sipas informacioneve të marra nga intervistat me institucionet, aktivitetet në këtë masë janë përmbushur plotësisht, por sipas informacioneve të kërkuara me karakter publik, nuk kemi marrë asnjë përgjigje dhe qëndrim nga ministria. Përsëri nënvizohet se kjo masë është e suksesshme në fakultetet teknike, ndërsa në fakultetet shoqërore është ende një problem.

3. "Bursimi i studentëve të huaj në universitetet shtetërore"

Kjo masë përfshin 4 aktivitete. Sipas planit të veprimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës është institucioni përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve.

Aktivitetet përfshijnë analizën e nevojave dhe mundësive, përgatitjen e konkursit, dhënien e bursave dhe vizita studimore të studiuësve nga jashtë. Nga intervistat me persona nga ky institucion jemi informuar se aktivitetet në këtë masë janë përmbushur plotësisht. Sipas informacioneve të kërkuara me karakter publik, nuk kemi marrë përgjigje nëse dhe në çfarë mase janë zbatuar këto aktivitete. Sipas të dhënave dytësore, aktivitetet në këtë masë në periudhën e planifikuar të zbatimit të strategjisë janë zbatuar. Shembuj të cituar nga kjo masë janë studentët me bursa në universitetet e Ohrit, Shtipit dhe Shkupit, kurse nga vizitat studimore të studiuësve nga jashtë mund të vërehen pothuajse në të gjitha universitetet shtetërore.

4. "Forcimi i kapaciteteve për përdorimin e fondeve ndërkombëtare"

Kjo masë përfshin një aktivitet, kurse institucioni përgjegjës është Sekretariati për Çështje Evropiane. Aktiviteti përfshin trajnime në kontakt pikat nacionale për programet e Bashkimit Evropian për inovacione, kërkime dhe zhvillimin. Sipas të gjitha instrumentave të përdorura në këtë analizë, nuk ka informacione në dispozicion për zbatueshmërinë e aktivitetit të parashikuar në planin e veprimit për këtë masë.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

Objektivi Strategjik Nr. 4 i Strategjisë nacionale për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lart dhe profesional, thotë:

” Rritja e shkëmbimit intelektual me botën e jashtme përmes nxitjes të bashkëpunimit me individë të arsimuar me prejardhje nga RM-ja që jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme me institucionet shkencore - kërkimore maqedonase dhe kompanitë e zhvillimit”

Përmbushja e përgjithshme e objektivit strategjik nr. 4 është 16%. Këtu mund të shihet se ky objektivi strategjik ka përqindjen më të madhe të përmbushjes nga të gjithë të tjerët.

Ky objektivi strategjik përfshin 4 masa, kurse këta janë:

1. "Bashkëpunimi institucional dhe mobiliteti"

Kjo masë përfshin dy aktivitete për të cilat është përgjegjëse Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Aktivitetet parashikojnë organizimin e përbashkët të ngjarjeve, rritjen e mundësisë për përdorimin e Programeve evropiane përmes bashkëpunimit të universiteteve vendase dhe të huaja dhe vendosjen e programeve për diploma të përbashkëta dhe bashkëpunimin e përbashkët. Sipas informacioneve të marra nga intervistat e bëra me institucionet, këto aktivitete janë përmbushur plotësisht, megjithatë, vetë përdoruesit përballen me sfida në pjesën e akreditimit të kualifikimeve të tyre. Nga ana tjetër,

bashkëpunimet me universitetet e huaja kanë qenë të shpeshta dhe të suksesshme, kurse si fakt janë nënvizuar marrëveshjet bilaterale që vendi ynë i ka kontraktuar me vendet e tjera, kurse përmes projekteve bilaterale shkencore- kërkimore vetëm në vitin 2019 janë bërë mbi 35 projekte për vizita, gjegjësisht për shkëmbime studimore. Nga informacionet e kërkuara me karakter publik, Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk ka dhënë informacione për përmbushjen e këtyre aktiviteteve. Nga të dhënat dytësore mund të konkludohet se aktivitetet e kësaj mase janë përmbushur në masë të madhe.

2. "Partneriteti në avancimin e administratës publike"

Kjo masë përfshin 5 aktivitete, kurse Ministria e shoqërisë informative dhe administratës është institucioni përgjegjës për përmbushjen e kësaj mase.

Për aktivitetet "analiza e nevojave" dhe "qëndrime të shkurtra të ekspertëve me origjinë nga Maqedonia e Veriut në institucionet shtetërore", nuk ka informacione as nga institucionet, as nga studimet dytësore nëse janë të arsyeshme. Për aktivitetin "Nxitja e lidhjeve midis organeve të administratës publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe vendeve të zhvilluara, të ndërtuara në bazë të propozimeve dhe kontakteve, kurse me pjesëmarrjen e mërgimtarëve tanë", nuk arritëm të gjejmë informacione që do të tregonin zbatueshmërinë e këtij aktiviteti. "Vizitat studimore të përfaqësuesve tanë në institucionet e huaja", sipas informacioneve pjesërisht është përmbushur ky aktivitet, kurse një nga bashkëbiseduesit e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës tha se edhe ai vetë ishte pjesë i një aktiviteti të tillë. Megjithatë, nuk kemi marrë asnjë informacion nëse kjo po zbatohet vazhdimisht. Për aktivitetin "Projekte për përmirësimin e segmenteve administrative, infrastrukturore dhe menaxhuese të sistemit për studime dhe zhvillim", morrëm përgjigje se ekzistojnë projekte të tilla dhe se po zbatohen në vazhdimësi. Si shembull për këtë u nënvizua edhe krijimi i Fondit për inovacione dhe zhvillim".

Nga informacionet e kërkuara me karakter publik, për aktivitetet në këtë masë, nuk ka informacione nëse janë zbatuar. Nga të dhënat dytësore, aktivitetet në këtë masë janë zbatuar pjesërisht.

3. "Rrjetëzimi"

Kjo masë përfshin 2 aktivitete, kurse Ministria e Arsimit dhe Shkencës është caktuar si institucioni përgjegjës për zbatimin e masës.

Me intervistat të zbatuara me institucionet, aktiviteti "Samiti global investues Mqedonia 2025" u zbatua plotësisht, kurse për të njëjtin mund lehtë të vihet deri në informacione, kurse për aktivitetin "Krijimi i bazës së të dhënave, ueb portalit apo rrjetit social me qëllim të vendosjes së komunikimit dhe rrjetëzimit me bursistët dhe diasporën shkencore me origjinë nga Maqedonia" nuk ka informacione. Nga informacionet e kërkuara me karakter publik nuk ka përgjigje kthyes nga institucionet. Nga të dhënat dytësore, gjithashtu, konfirmohet se njëri aktivitet është zbatuar plotësisht, ndërsa për aktivitetin e dytë nuk ka informacione se është zbatuar.

4. "Mentorimi"

Kjo masë përfshin 5 aktivitete, kurse institucioni përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve është Ministria e Ekonomisë.

Aktivitetet përfshijnë analizën e nevojave, përgatitjen e programit dhe zbatimin e proceseve konkurruese të përzgjedhjes të kompanive të mbështetura, projekte dhe institucione, projekte për programin e mentorimit të sipërmarrësve, programi për bashkë-mentorimin e punës shkencore - kërkimore .

Nga të gjitha veçat e përdorura për këtë masë analiza tregoi se nuk ka informacione mbi zbatueshmërinë e aktiviteteve.

KONKLUDIMI

Mesatarja e përmbushjes së tërësishme të Strategjisë është 11%. Sipas të gjitha të dhënave të kryqëzuara, mund të konkludojmë se institucionet nuk e kanë përfshirë këtë Strategji në axhendën e tyre. Strategjia u miratua në vitin 2013, kurse plani i veprimit u miratua në vitin 2014. Nuk ka plane të tjera veprimi. Aktivitetet janë zbatuar pjesërisht ose nuk janë zbatuar fare.

Në të dhënat e paraqitura sipas objektivit strategjik, përmbushja e masave dhe aktiviteve, vërehet se aktivitetet nuk zbatohen sipas plan-veprimit të parashikuar dhe se nuk janë miratuar plane të reja veprimi. Institucionet nuk kanë informacione të brendshme nëse janë dhe sa zbatohen aktivitetet.

Në pyetjet dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si bartës i Strategjisë, se si e vlerësojnë bashkëpunimin me faktorët e tjerë (institucionet, organizatat dhe palët e tjera të interesuara), përgjigja është se ka një bashkëpunim të pjesshëm në lidhje me Strategjinë.

Institucionet që ishin pjesë e intervistave i identifikuan problemet e mëposhtme: mospërputhje të politikave, ndryshimi i shpeshtë i pozitës udhëheqëse në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, mungesë e kapaciteteve, dëshirave dhe motivimit tek burimet njerëzore, mungesë e fondëve financiare, si dhe krizë politike.

Si rekomandime të dhëna nga institucionet dhe të rinjtë që ishin pjesë e hulumtimit në këtë analizë janë:

- 1 Bashkëpunimi më i madh me të gjithë palët e interesuara
- 2 Përfshirje më e madhe e të rinjve në krijimin e strategjive
- 3 Planifikimi strategjik afatgjatë dhe krijimi i planeve të veprimit
- 4 Konsistenca e politikave
- 5 Zbatimi i planeve të veprimit dhe strategjive aktuale.

Objektiv strategjik

4% Niveli i përbushjes

OS1: Krijimi i sistemit nacional për menaxhimin me lëvizjen e individëve me arsim të lartë nga vendi dhe aktivizimi zhvillimor të potencialeve të emigracionit intelektual

9% Niveli i përbushjes

OS2: Zvogëlimi i derdhjes të trurëve përmes rritjes të atraktivitetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si vend për punë dhe angazhimin e personave të rinj me arsim të lartë

15% Niveli i përbushjes

OS3: Kalimi nga derdhja drejt prurjes së kudrove me arsim të lartë përmes rritjes të nivelit dhe vëllimit të kthimit të emigracionit intelektual nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe rritjen e vetëdijes për zhvillimin e kapitalit njerëzorë

16% Niveli i përbushjes

OS4: Rritje e këmbimit intelektual me botën e jashtme përmes nxitjes të bashkëpunimit me individët e arsimuar me origjinë nga Republika e Maqedonisë së Veriut të cilit jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme me institucionet shkencore-kërkimore dhe kompanite zhvillimore maqedonase

11% Përbushja e strategjisë në përgjithësi

PJESA 2

NDIKIMI I STRATEGJISË

Që të kuptohet ndikimi (impakti) i Strategjisë u përdorën veglat e mëposhtme:
online kolazhi, dhe intervista personale me të rinjtë.

ONLINE SONDAZHI – TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Me sondazhin (anketën) u pyetën të rinjtë që ende jetojnë në shtetin tonë, por edhe ata që janë shpërngulur viteve të fundit. Të anketuarit plotësuan një online anketë në të cilën u parashtruan pyetje në lidhje me ndikimin e Strategjisë.


Në suazat e anketës arritën 1,192 përgjigje. Pyetjet ishin ndarë në:

- 1** Karakteristika të përgjithshme demografike
- 2** Pyetje për të rinjtë që jetojnë në shtetin tonë
- 3** Pyetje për të rinjtë që janë shpërngulur.

Në pyetjen: „A jetoni aktualisht në Republikën e Maqedonisë së Veriut?” 1,137 të anketuarit, ose 95,40%, u përgjigjën PO, ndërsa 55 të tjerët, ose 4,60%, u përgjigjën JO.”

Nga të dhënat demografike mund të vërehet se nga 1.192 të anketuarit që janë përgjigjur, 1,137 janë banorë të përhershëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse 55 të anketuarit janë shpërngulur nga shteti ose janë ish-banorë të përhershëm.

Vendbanimi i përhershëm i të anketuarëve është Republika e Maqedonisë së Veriut



Grupi i parë i pyetjeve ka të bëjë me përvorjat e shpërnguljes dhe u dedikohen atyre të rinjve që janë shpërngulur nga shteti. Të anketuarit përgjigjen në temat e mëposhtme:


- Vendi i vendbanimit aktual;
- Arsyet e shpërnguljes së tyre;
- Vlerësimi i përbushjes së pritjeve;
- Të menduarit për kthimin mbrapa, dhe
- A janë të informuar për punën e institucioneve në fushën e parandalimit të derdhjes të trurëve dhe bashkëpunimit me mërgimtarët.

Grupi i dytë i pyetjeve ka të bëjë me personat që ende jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në këtë pjesë të pyetësorit të anketuarit përgjigjen në temat e mëposhtme:

- Dëshira për ta braktisur ose për të mbetur në shtetin tonë;
- Arsyet për shkak të cilave do ta kishin braktisur shtetin;
- Vlerësimi i funksionalitetit të institucioneve, njoftimi me aktivitetet e institucioneve dhe e ngjashme.


Mosha e të anketuarëve që janë përgjigjur në këtë anketë: shumica dërmuese janë njerëz të rinj deri në moshën 30 vjeçare ose 1,145 persona (96% nga të anketuarit), kurse 47 persona (4% nga të anketuarit) janë të moshës mbi 30 vjeçare.

Mosha e të anketuarëve



699 persona ose 59% identifikohen me gjininë femërore, 486 persona ose 41% identifikohen me gjininë mashkullore, ndërsa 7 persona ose 0.5% përgjigjen me tjerë. Mund të konkludojmë se, sipas strukturës gjinore, pyetësori aktual iu afrua përfaqësimit të barabartë gjinor.

Gjinia e të anketuarëve



NJOFTIMI ME STRATEGJINË NGA PERSONAT QË E KANË PLOTËSUAR ANKETËN

Nga kategoria e personave që janë banorë të përhershëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, sondazhi arriti të mbledhë përgjigje nga 1,136 persona.

Në pyetjen: "A keni dëgjuar për Strategjinë për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional 2013-2020?" 1.015 persona ose 89.3% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk janë njoftuar me strategjinë, kurse 121 persona ose 10.7% e të anketuarve janë përgjigjur se janë njoftuar me strategjinë.


Njoftimi me Strategjinë nga personat që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut



Nga kategoria e personave që nuk janë banorë të përhershëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut anketa arriti të merrë përgjigje nga 55 persona.

Në pyetjen "A keni dëgjuar për Strategjinë për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional 2013-2020?" 52 persona, ose 94,5% nga të anketuarit janë përgjigjur se nuk kanë dëgjuar për strategjinë, kurse 3 persona, ose 5,5% nga të anketuarit janë përgjigjur se kanë dëgjuar.


Njoftimi me Strategjinë nga të rinjtë që janë shpërngulur nga shteti



Në vazhdimin e pyetjeve, i pyetëm mërgimtarët "A keni dëgjuar / a keni marrë pjesë në ngjarje promovuese jashtë vendit, për afirmimin e politikës për zvogëlimin e derdhjes të kadrove me arsim të lartë, ose në forumet e ekspertëve maqedonas jashtë vendit? "

Në këtë pyetje, dy të anketuar ose 4% u përgjigjën PO dhe 54 ose 96% nga numri i përgjithshëm prej 56 të anketuarve u përgjigjën JO.


A keni dëgjuar / a keni marrë pjesë në ngjarje promovuese jashtë vendit?



Nga të dhënat cilësore, ngjarjet në të cilat kanë marrë pjesë të anketuarit janë rajonale dhe të organizuar nga palë të treta.

Në këtë seri pyetjesh pasoi pyetja: "A keni marrë pjesë në aktivitete që lidhen me rrjetet tematike dhe shoqatat shkencore për kërkim dhe zhvillim, institucionet akademike dhe organizatat kërkimore ku punojnë kadro me origjinë nga Maqedonia? " Shumica dërmuese prej 96% nuk kanë marrë pjesë në asnjë aktivitet.


Pjesëmarrje e aktiviteteve në lidhje me rrjetet tematike dhe shoqatat shkencore për hulumtim dhe zhvillim



Për më tepër, kemi dashur të shohim qëndrimin e banorëve të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Fjala vijon: "Në pesë vitet e fundit, po rritet atraktiviteti i vendit tonë si një vend për punë dhe angazhimin e personave të rinj me arsim të lartë. "

Shumica e të anketuarve, ose 62.67%. nuk pajtohen me qëndrimin e propozuar. Pas tyre pasojnë ata që janë në mes, d.m.th as pajtohen dhe as nuk pajtohen, d.m.th 12.67% e të anketuarve. 11% nuk pajtohen pjesërisht, 8.97% pajtohen pjesërisht, kurse një përqindje e vogël ose 1.23% pajtohen. Dhe e fundit, 3,25% e të anketuarve janë përgjigjur "nuk di".

Institucionet shtetërore maqedonase, përmes bashkëpunimit, i përdorin potencialet e mërgimtarëve me kualifikime të larta




Shumica dërmuese (62%) e të anketuarve konsiderojnë se institucionet nuk e përdorin potencialin e mërgimtarëve me kualifikime të larta, ndërsa vetëm 6% e të anketuarve pajtohen ose pjesërisht pajtohen. Një përqindje e konsiderueshme (24%) nuk kishte përgjigje në këtë pyetje.

Në pjesën e pyetjeve drejtuar personave që janë banorë të përhershëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, filluam me pyetjen, "A mendoni se ka ndonjë ndryshim të dukshëm në vëllimin e kthimit të kuadrove me kualifikime të larta në vend in tone në pesë vitet e fundit? "

Në këtë pyetje shumica dërmuese e të anketuarve - 87.94% janë përgjigjur "jo", ndërsa 9.24% janë përgjigjur "nuk di", kurse një numër i vogël ose 2.81% e të anketuarve deklaruan se ka ndryshime të dukshme në vëllimin e kthimit të kuadrove me kualifikime të larta në vendin tonë.

Ekzistimi i ndryshimeve në vëllimin e kthimit të kuadrove me kualifikime të larta në vendin tonë në pesë vitet e fundit




Të njëjtit personë u përgjigjën edhe në pyetjen "A keni dëgjuar për bursa të studentëve të huaj në universitetet shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut ? " Një përqindje e lartë ose 78.52% janë përgjigjur pozitivisht, kurse 27.47% e përgjigjeve janë negative.

Nga të dhënat cilësore konform kësaj pyetjeje, ata të anketuarit që u përgjigjën pozitivisht në këtë pyetje, nënvizuan se kishin dëgjuar për bursa të tilla, por nuk njohin ndonjë person që e ka fituar këtë bursë. Si shembuj numrohen universitetet që pranojnë studentë të huaj, Ministria e Arsimit dhe Shkencës - bursa për studentët nga ish-Jugosllavia, dhe studentë nga Turqia.

Përgjigjet e përmbledhura në mënyrë të përgjithëshme japin shembuj, por vetë të anketuarit nuk janë të informuar se cila është procedura e dhënies të këtyre bursave, cilat janë kriteret dhe kush i jep ato.


Njoftimi me bursimin e studentëve të huaj në universitetet shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut



Për më tepër, kemi dashur të shohim qëndrimin e banorëve të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Fjalja vijon: "Në pesë vitet e fundit, po rritet atraktiviteti i vendit tonë si një vend për punë dhe angazhimin e personave të rinj me arsim të lartë."

Shumica e të anketuarve, ose 62.67%, nuk pajtohen me qëndrimin e propozuar. Pas tyre pasojnë ata që janë në mes, d.m.th as pajtohen dhe as nuk pajtohen, d.m.th 12.67% e të anketuarve. 11% nuk pajtohen pjesërisht, 8.97% pajtohen pjesërisht, kurse një përqindje e vogël ose 1.23% pajtohen. Dhe e fundit, 3,25% e të anketuarve janë përgjigjur "nuk di".

Rritje e atraktivitetit të vendit tonë në 5 vitet e fundit si vend për punë dhe angazhim të personave të rinj me arsim të lartë




Pyetja tjetër përfshin drejtpërdrejt disa nga masat e parashikuara në Strategjinë dhe i pyet të anketuarit "A keni dëgjuar për programet e mentorimit, të organizuara nga institucionet kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të transferuar njohuritë midis kuadrove me arsim të lartë në vendin tuë dhe mërgimtarëve jashtë vendit?"

Në këtë pyetje shumica e të anketuarve ose 93.22% u përgjigjën me "PO", kurse 6.69% u përgjigjën me "JO".

Nga informacionet cilësore, personat i përmendin si shembuj programin Erasmus +, dërgimin e personelit mjekësor jashtë shtetit, masat për rikualifikime në APRMV (Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut).

Njoftimi me programet e mentorimit



INTERVISTË ME TË RINJTË – TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Intervistat u zbatuan nga hulumtuesit në terren dhe u zhvilluan drejtpërdrejt me të anketuarit. U realizuan gjithsej 12 intervista. Intervista të ndryshme i realizuam me:

1. Persona të rinj me arsim të lartë të cilit ende jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

2. Persona të rinj me arsim të lartë që janë shpërngulur jashtë shtetit.

Qëllimi i intervistave dhe anketës janë:

- Njohja e qëndrimeve, sfidave dhe rekomandimeve

-Përcaktimi nëse dhe në çfarë mase strategjia u është e njohur të rinjve, por edhe popullates së përgjithshme.

Nga gjashtë intervistat e realizuara me të rinjtë që janë banorë të përhershëm të shtetit, të dhënat demografike tregojnë se 2 persona janë të moshës 23 vjeçare, 2 persona janë të moshës 25 vjeçare, 1 person i moshës 27 vjeçare dhe një person i moshës 32 vjeçare. Në përqindje, të dhënat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

NJOFTIMI ME STRATEGJINË E PERSONAVE TË RINJ ME TË CILIT ËSHTË REALIZUAR INTERVISTA

Me të rinjtë që janë banorë të përherëshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u realizuan gjithsej 6 intervista.

Në pyetjen: "A keni dëgjuar për Strategjinë për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional 2013-2020?" nga gjithsej 6, 5 persona u përgjigjën se nuk kanë dëgjuar për Strategjinë, kurse 1 person është përgjegjur se ka dëgjuar.

Personi që u përgjigj se ka dëgjuar për Strategjinë tha se nuk ka informacione konkrete për të njejtën, por kishte dëgjuar që ekzistonte një strategji e tillë.

Nga kategoria e personave që janë shpërngulur nga Republika e Maqedonisë së Veriut, janë realizuar gjithsej 6 intervista.

Në pyetjen: "A keni dëgjuar për Strategjinë për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë dhe profesional 2013-2020?", 5 persona u përgjigjën se nuk kanë dëgjuar për Strategjinë, kurse 1 person u përgjigj se ka dëgjuar.

Personi që u përgjigj se ka dëgjuar për Strategjinë tha se nuk ka asnjë informacion konkret për të njejtën, por kishte dëgjuar që një strategji e tillë ekzistonte. Në pyetjen: "Gjatë qëndrimit tuaj jashtë vendit, a keni bashkëpunuar me ndonjë nga institucionet tona ose me sektorin e biznesit?"

5 persona u përgjigjën se nuk kanë bashkëpunuar me institucione ose persona juridikë në asnjë mënyrë, ndërsa 1 person nga gjithsej 6 u përgjigj se ka bashkëpunuar me institucionet.

Nga përgjigjet cilësore, personi që ka dhënë përgjigje pozitive, sqaron se ekziston bashkëpunimi me fakultetet maqedonase me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe ideve në fushën e shkencës. Të tjerët nuk sqarojnë pse ka ndërprerje në komunikimin me institucionet dhe personat juridikë në shtetin tonë.

Në pyetjen: "A keni dëgjuar / a keni marrë pjesë në ngjarjet promovuese jashtë vendit për afirmimin e politikës për zvogëlimin e derdhjes të kuadrove me arsim të lartë, ose të forumeve të ekspertëve maqedonas jashtë vendit?", të gjithë të 6 të intervistuarit u përgjigjën negativisht.

Nga kjo mund të konkludojmë se të rinjtë që jetojnë jashtë vendit nuk janë kontaktuar për pjesëmarrje në ngjarje nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e strategjisë. Kjo është tërësisht për shkak të moszbatimit të strategjisë nga ana e institucioneve përgjegjëse për zbatimin e saj.


Në pyetjen: "A keni hasur në ndonjë artikull në media, ku aktualisht ata jetojnë, ku janë promovuar përfaqësues të emigracionit maqedonas?" 4 persona u përgjigjën se nuk ishin të njohur me artikujt e mediave, ndërsa 2 persona u përgjigjën se janë të njohur me artikujt e mediave.

Nga të dhënat cilësore, të anketuarit u përgjigjën se rrjetet sociale janë një mjet në të cilin njihen me anëtarët e shquar të emigracionit maqedonas, ndërsa në të njëjtën kohë edhe online mediat kontribuojnë për promovimin e tyre.

Në pyetjen: "A keni marrë pjesë në aktivitete në lidhje me rrjetet tematike dhe shoqatat shkencore për hulumtim dhe zhvillim, institucionet akademike dhe organizatat kërkimore ku punojnë kuadro me origjinë nga Maqedonia?", nga gjithsej 6, 3 persona nga të rinjtë e anketuar të shpërngulur janë përgjigjur se deri më tani kanë marrë pjesë në aktivitete të zbatuara nga organizata dhe institucione të ndryshme, ndërsa 3 personat e tjerë u përgjigjën se deri më tani nuk kanë marrë pjesë në ngjarje të tilla.

Si shembuj të listuar janë bashkëpunimet e grupeve kërkimore në të cilat punojnë Maqedonas, si dhe përmes pjesëmarrjes në institucionet ku punojnë maqedonas. Më së shpeshti kjo praktikë fitohet mbi baza personale ose përmes rrjetëzimit të kuadrove përmes institucioneve të pavarura nga autoritetet shtetërore dhe nëmënyrë indirekte kontribuon drejt rezultateve pozitive, megjithëse proceset nuk inicohen ose zbatohen nga shteti.


Nga të gjitha përgjigjet në dispozicion për të anketuarit, mund të konkludojmë se Strategjia nuk ka pasur asnjë ndikim në target grupin. Duke pasur parasysh faktin se vetëm një pjesë shumë e vogël është përmbushur nga e njëjta, ky target grup, gjegjësisht, të rinjtë e shpërngulur përgjithësisht nuk janë njoftuar me Strategjinë dhe qëllimet e saj.





REKOMANDIME

ÇFARË NUK KA NË STRATEGJI, KURSE ËSHTË REFERUAR NË INTERVISTAT ME INSTITUCIONET DHE TË RINJTË



Në intervistat e referuara me të rinjtë dhe institucionet përveç për njoftimin dhe përmbushjes së Strategjisë, u parashtrua edhe pyetja - çfarë konsiderojnë se mungon në Strategjinë, kurse duhet të jetë e përfshirë. Si sfidat perceptohen mungesa e bashkëpunimit dhe komunikimit mes të gjitha palëve të interesuara dhe mospërputhjen në krijimin dhe zbatimin e politikave. Institucionet dhe të rinjtë që i përfshimë në këtë analizë referojnë segmente të rëndësishme në të cilat konsiderojnë se krijimi i masave që do të ndikojnë në këto zona do të kontribuojnë për zvogëlimin e derdhjes të trurëve dhe zbatimin e suksesshëm të strategjive të cilat në të ardhmen do t'i miratojnë ministrinë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

OPINIONET E TË RINJVE QË JETOJNË NË VENDIN TONË

Të rinjtë që janë banorë të përhershëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut referuan disa segmente që ata konsiderojnë se mungojnë në Strategjinë aktuale dhe se duhet të përfshihen në Strategjinë e re, nëse e njëjta do të miratohet. Nga të dhënat e përmbledhura, propozimet mund t'i ndajmë në tre fusha edhe atë:

1 *Ekonomia*

2 *Arsimi*

3 *Komunikimi dhe motivimi*

Në fushën që e kemi quajtur "Ekonomia", qytetarët e rinj të shtetit referojnë disa masa të cilat konsiderojnë se duhet të përfshihen në Strategjinë në të ardhmen.

Ekonomia

01

Të kihet kujdes në lidhje me zhvillimet politike në drejtim të ndërtimit të një rritje të qëndrueshme ekonomike në një mjedis politikisht të qëndrueshëm

02

Të zbatohet një analizë të nevojave të tregut të punës dhe të ofrohen masa adekuate

03

Të përshtaten programet arsimore

04

Të ofrohen trajnime dhe diploma me cilësi të lartë për të fituar aftësi që do t'i përgatit të rinjtë të marrin pjesë në tregun e punës

05

Të sigurohen kushte për punë duke e mbrojtur punëtorin dhe të ofrohen mundësi për përmirësimin dhe avancimin në punë

06

Të motivohen punëtorët dhe të shfrytëzohen kapacitetet e tyre për të zhvilluar ekonominë dhe shoqërinë

Arsimi

Arsimi luan një rol kryesor në vendimin e të rinjve për t'u larguar nga vendi. Prandaj, edhe të rinjtë e theksojnë atë si një fushë për të cilën duhet t'i kushtohet vëmendje dhe të krijohen masa që do të sjellin rezultate pozitive.

01

Rritja e cilësisë, peshës dhe njohjes së diplomave universitare

02

Modernizimi i programeve arsimore

03

Përfshirja e teknologjisë së re

04

Sigurimi i kushteve për kërkime, trajnime dhe praktikë cilësore për studentët

Komunikimi ndërinstiucional

Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve është një problem i madh gjatë realizimit të objektivave të Strategjisë, kurse vetë komunikimi nuk është i zhvilluar dhe i përfshirë në mënyrë të mjaftueshme në këtë Strategji. Përveç bashkëpunimit ndërinstiucional, të rinjtë konsiderojnë se bashkëpunimi me biznesin dhe shoqërinë civile mund të kontribuojë për një rritje të suksesshme të cilësisë së jetës së të rinjve.

Motivimi numrohet në këtë fushë si gjë kryesore për përmbushen vullnetare të të gjitha objektivave dhe strategjive që duhet të zbatohen në të ardhmen. Motivimi tek vetë institucionet dhe tek të rinjtë për zgjidhjen e problemeve dhe për të qëndruar në shtet është në një nivel shumë të ulët, sipas të rinjve. Nëse motivimi rritet në mënyrë të qëndrueshme, atëherë edhe vetë proceset më lehtë do të japin fryte.

OPINIONI I TË RINJVE QË JANË SHPËRNGULUR

Të rinjtë të cilët janë shpërngulur jashtë vendit, e japin mendimin e tyre për atë se në çfarë mënyrë duhet të qaset për të zgjidhur problemin të cilin e kanë përpunuar në këtë analizë. Sipas të dhënave të përpunuara, mund të konkludojmë se këto fusha janë kruciale për sukses edhe tek personat e rinj të shpërngulur, megjithatë, duke pasur parasysh që ata nuk jetojnë në shtetin tonë, ata rekomandojnë një qasje pak më të ndryshme kur bëhet fjalë për përfshirjen e tyre në zgjidhjet e mundshme të problemit.

Fushat edhe kësaj here janë:

1

Ekonomia

2

Arsimi

3

*Komunikimi
ndërinstitucional*

1. Ekonomia

Nga të rinjtë që janë shpërngulur nga shteti, në fushën e ekonomisë, janë referuar rekomandime për avancimin e orientimit në karrierë, ofertë për fitimin e aftësive praktike dhe përgjithësisht përmirësimin e cilësisë së jetës të njeriut të ri.

Orientimi në karrierë në bashkëpunim me sektorin e biznesit mund t'a balancojë tregun e punës, gjegjësisht t'ju përgjigjet nevojave të tregut përmes formësimit të kuadrove cilësore që do të trajnohen dhe do të përgatiten të ballafaqohen me tregun. Përmes sigurimit të aftësive praktike dhe masave që u përgjigjen sfidave të arsimit profesional, në mënyrë shtesë do t'i rritë konkurrencën dhe punësueshmërinë e të rinjve që kapacitetet e tyre do të mund t'ia ofrojnë ekonomisë lokale.

Përmirësimi i cilësisë së jetës përmes modernizimit të vazhdueshëm të sektorëve që nuk janë përmendur këtu, siç janë shëndetësia, gjyqësori, mjedisi dhe të ngjashme, me ç'rast në mënyrë shtesë do të rritet atraktiviteti i vendit për të rinjtë që përfshihen në tregun e punës.

Këta të rinj konsiderojnë se këto nënfusha janë të rëndësishme për t'i mbajtur trurët në shtetin tonë. Çrrënjësja e korrupsionit si një problem sistematik, oferta e zgjidhjeve sistemike dhe nxjerrja e ekonomisë dhe të biznesit jashtë kthetrave të politikës, do të kontribuojë për përmirësimin e mirëqenies të të rinjve dhe investime në kapacitetet e tyre në shtet.

2. Arsimi

Në pjesën e arsimit, këta të rinj rekomandojnë reforma thelbësore arsimore, forcimin e kapaciteteve të institucioneve arsimore, përfshirjen e teknologjisë bashkëkohore, mundësimin e aftësive praktike për të rinjtë, si dhe këmbimin e përvojave dhe njohurive me bashkëmoshatarët e tyre nga jashtë.

Reformat arsimore duhet të sjellin freski në procesin dhe t'i aftësojnë të rinjtë për ndërtimin e ardhmërisë. Përmes bashkëpunimit me institucionet të mundësohet përfshirja e teknologjisë bashkëkohore, monitorimi i vazhdueshëm i tendencave në arsim, praktikë cilësore dhe e paguar për nxënësit dhe studentët e rinj me qëllim që të motivohet aktiviteti i tyre në shtetin tonë.

Të mundësohet bashkëpunimi dhe shkëmbimi i përvojave dhe njohurive përmes instrumenteve të ndryshme që janë në dispozicion të institucioneve për të rinjtë me bashkëmoshatarët e tyre nga jashtë. Investimi në zhvillimin e projekteve kërkimore, sigurimi i hapësirës për përmirësimin e njohurive dhe përvojës praktike para përfundimit të procesit arsimor.

3. Komunikimi ndërinstytucional

Komunikimi ndërinstytucional, si dhe komunikimi i institucioneve me mërgimtarët, është diçka që të rinjtë e shpërngulur nga shteti e cilësojnë si mungesë, por edhe një proces i domosdoshëm për krijimin e një ambienti tërheqës për të rinjtë. Bashkëpunimi mund të sjellë shumë ide, ekspertizë, përvojë dhe njohuri nga njerëzit e shpërngulur, por edhe të krijojë një rrjet të kapaciteteve që shteti mund t'i përdorë për t'a përmirësuar cilësinë e jetës në të gjitha fushat e vendit. Promovimi i aktiviteteve, masave dhe hapave që shteti po i ndërmerret është, gjithashtu një segment i rëndësishëm për krijimin e një dialogu me mërgimtarët. Përmes informimit të të gjitha palëve të interesuara dhe përfshirja e tyre në proceset, mund të arrihet një efekt i madh, konsiderojnë mërgimtarët e rinj.

Institucionet shtetërore që i kemi intervistuar në kuadër të kësaj analize, referojnë se, duke u pajtuar me të rinjtë, se bashkëpunimi dhe komunikimi janë thelbësore për të arritur sukses dhe rezultate të dukshme në parandalimin e derdhjes të trurëve. Për më tepër, institucionet referojnë se vetëm përmes vazhdimësisë së politikave të zbatuara nga institucionet mund të arrihen rezultate. Qasja sistematike ndaj problemit dhe veprimi thelbësor si dhe zbatimi konsekuent i dokumenteve strategjike, në mënyrë aktive do t'a nxitë dhe motivojë sistemin që të ballafaqohet me problemet, kurse kjo e tërhek edhe ndarjen e fondeve më të mëdha financiare të nevojshme për realizimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave të përcaktuara.

ADRESIMI I SFIDAVE DHE PLANIFIKIMI STRATEGJIK

Gjatë intervistave me departamentet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, përgjegjës për këtë çështje - Departamenti për Planifikimin Strategjik dhe Analizën dhe Sektori për Shkencë dhe Inovacione, u adresuan edhe sfidat dhe planifikimi strategjik i Strategjisë.

Duke pasur parasysh që ministritë punojnë sipas dokumenteve dhe programeve strategjike të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, këto departamente nënvizuan se në momentin e realizimit të intervistave, Ministria e Arsimit dhe Shkencës është duke punuar në bazë të një programi 4-vjeçar për punën e Qeverisë, pjesë e të cilave janë programet për secilin vit veç e veç. Ata që u listuan nga bashkëbiseduesit ishin: Reforma e Administratës Publike, Strategjia për Barazinë Gjinore, Plani Nacional i Veprimit për Arsimin, Strategjia për Inovacione (2012-2020) dhe Strategjia e Arsimit.

Në të njëjtën kohë, ministria është duke punuar në bazë të një plani strategjik tre vjeçar për punë (2019 - 2021), kurse në të njëjtën kohë punohet edhe në një plan strategjik për periudhën e ardhshme tre-vjeçare (2020 - 2022).

Nga ana e bashkëbiseduesve, përveç Strategjisë nacionale për rrjetëzimin, bashkëpunimin dhe zvogëlimin e derdhjes të kadrove me arsim të lartë dhe profesional (2013-2020), nuk ekziston një dokument tjetër strategjik që në mënyrë të drejtpërdrejtë punon në këtë çështje. Programet e tjera të punës dhe dokumentet strategjike, ndoshta në mënyrë indirekte janë orientuar në zgjidhjen e kësaj çështjeje,

Përveç këtyre dokumenteve strategjike, programet e punës përfshijnë edhe masa që në njëfarë mënyre janë drejtuar ndaj kësaj çështjeje. Si shembull, bashkëbiseduesit e përmendën masën "Bursimi I programeve për studentët që studiojnë jashtë vendit, kurse janë të detyruar të kthehen në vend pasi të përfundojnë studimet në një periudhë 2-vjeçare".

Në lidhje me procesin e planifikimit strategjik në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, bashkëbiseduesit tonë theksuan se kur është themeluar Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi programin 4-vjeçar, prioritetet dhe qëllimet e punës. Pastaj këto dokumente u jan shpërnda Ministrisë dhe të punësuarëve që mund të japin përgjigje. Strategjitë miratohen në muajin qershor dhe patjetër duhet të jenë komplementare me buxhetin, gjegjësisht t'i ndjekin mundësitë që buxheti i ka për zbatimin e tyre. Për më tepër, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Sektori i planifikimit strategjik i punon të njëjtat dokumente brenda dhe përcakton masa dhe objektiva në koordinim me të gjithë sektorët. Çdo sektor jep rekomandime dhe fidbekun e tyre, dhe gjithashtu, propozon dhe inicon masa dhe aktivitete për zbatimin e strategjive. Sipas bashkëbiseduesve, këto dokumente dhe plane për punë përgatiten përmes konsultimit të brendshëm, pra me faktorët që ekzistojnës brenda institucioneve. Konsultime të gjera të jashtme me të gjitha palët e interesuara nuk bëhen, kurse sipas bashkëbiseduesve, nuk ka nevojë pasi vetë ministria bënë vlerësimin e aktiviteteve.

Sa i përket vlerësimit dhe raportimit, bashkëbiseduesit thonë se përgatiten raporte tremujore dhe vjetore nga të gjitha palët përgjegjëse dhe dërgohen në Qeveri. Raportet vjetore publikohen publikisht, ndërsa raportet tremujore janë për përdorim të brendshëm. Sipas të dhënave, për raportet bëhet vlerësimi i asaj që është planifikuar dhe që është zbatuar dhe përmbledhen të dhënat, të cilat më vonë i shqyrton Qeveria.

Si sfida të këtyre proceseve, bashkëbiseduesit i përmenden arsyet që shpesh hasen në këtë analizë: mungesa e shfrytëzimit të kapaciteteve të të punësuarve dhe të financave. Për më tepër, në kohën e realizimit të intervistës, një nga bashkëbiseduesit theksoi se sfidë paraqet edhe fakti që Sektori I planifikimit strategjik në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës nuk ka udhëheqës.

Nga këto informacione të paraqitura mund të konkludojmë se gjatë miratimit të këtyre dokumenteve të rëndësishme, procesi nuk është mjaftueshëm inkluziv, gjegjësisht në vetë procesin nuk janë përfshirë palët e interesuara dhe vetë përdoruesit e masave dhe aktiviteteve të planifikuara në dokumentet. Nevojiten konsultime të gjera me të gjitha masat e interesuara, për të rritur cilësinë e proceseve, por edhe për t'u përgjigjur nevojave reale të atyre të cilëve u referohen këto dokumente. Për më tepër, përgjigjja ndaj sfidave, gjegjësisht shfrytëzimi më i madh i kapaciteteve të të punësuarve dhe nëse ekziston një komplementaritet i strategjive me buxhetin qendror, do të merret parasysh në vetë procesin e planifikimit.



PARAMETRAT JOEKONOMIKE

Nëse e përjashtojmë faktorin ekonomik si arsye kryesore për derdhjen e kuadrove me arsim të lartë dhe profesional nga shteti, mund të vërrehet se ai nuk është 'l vetmi, por edhe as faktor kryesor për miratimin e vendimit për shpërngulje

Të rinjtë që janë banorë të përhershëm të shtetit.

Në pyetjen: "Unë do të shpërngulem nga shtetii nëse ...", të rinjtë që janë banorë të përhershëm në shtetin tone, u përgjigjën kështu:

„ Nuk pata sukses në biznes. Sipas mendimit tim, mënyrë e vetme për një sukses real është për të filluar biznesin e vetë, ku në asnjë rast nuk do varem nga punëdhënësi".

„ Kam një mundësi të mire që të aftësohem më shumë, të marrë kushte më të mira për punë praktike me njerëzit që në mënyrë të drejtë do ta vlersëojnë punën, si dhe kushte më të mira themelore për jetë" .

„ Unë do të shpërngulem nga shteti nëse nuk do të gjejë punë e cila do t'më plotësojë (kënaqësia nga kushtet e punës, mundësia për përparimin dhe avancimin gradual dhe marrjen e funksioneve më të larta, etj.) dhe do t'më mundësojë financa të mjaftueshme për jetë e cila do të jetë e përmbushur dhe dinamike".

„ Të marrë një ofertë të mire pune".

„ Nëse nuk përmirësohet më mire cilësia e jetës që e ofron shteti".

„ Nuk mund të gjejë një ambient pune të cilit i përkas dhe nga i cili kam mbështetje, nëse puna ime dhe angazhim im nuk vlerësohen".

Nga këto përgjigje mund të konkludohet se cilësia e jetës që është edhe arsyeja më shpesh e përmendur, nuk varet vetëm nga financat që i fitojnë personat, por edhe nga fusha të tjera. Kryesisht mundësitë për zhvillimin personal, shëndetësia, arsimi dhe të tjerë, llogariten në vetë cilësinë e jetës.

Në pyetjen: "Në çka ju asocion të jetosh në vendin tonë?", të rinjtë nga vendi që i kemi intervistuar theksuan se të jetosh këtu i asocion në "vend-numrim", "mungesë e mundësive", "sistem jofunksional", "korrupsion", ose në mënyrë metaforike në "kopsht të harruar". Pikërisht këto përgjigje janë e kundërta e përgjigjeve që i kemi marrë në pyetjen e mëposhtme:

„Në çka ju asocion të jetosh jashtë vendit tonë?“

Në lidhje me këtë i marrëm këto përgjigje: „shans për përparim“, "më shumë mundësi", "sistem funksional", "jetë në paqe", "jetë optimale" dhe të tjera.

Përveç këtyre pyetjeve, kërkuam prej të rinjve të identifikojnë tre arsye (përveç faktorit ekonomik) që do të kontribuojnë në vendimin e tyre që të shpërngulen. U kemi kërkuar që t'i rendisin ato nga më të rëndësishmet deri tek ato më të parëndësishmet, kurse si më e rëndësishmja në pjesën më të madhe të përgjigjeve e kemi marrë shëndetësinë, komplementare me mjedisin, pastaj funksionalitetin e dobët dhe mosbesimin ndaj institucioneve, mentalitetin e qytetarëve, pasigurinë, mungesën e sensit të sigurisë dhe të tjerë.

Të gjitha këto arsye kanë një ndikim të madh në vendimin për shpërnguljen e të rinjve, por, megjithatë, nuk e paraqesin të ashtuquajturin faktor ekonomik. Këto arsye janë shumë në numër dhe paraqesin një shtyllë të funksionalitetit të shoqërisë. Të gjithë ata sektorë, shkaqet apo faktorët të cilët të rinjtë i identifikojnë si dobësi ose nxitës të emigracionit, luajnë një rol të madh në zhvillimin dhe mirëqenien e individit, por edhe të shoqërisë në përgjithësi. Pikërisht këto arsye, me një tempo të madhe e përshejtojnë vendimin e të rinjve për t'u larguar nga shteti.

Të rinjtë që jetojnë jashtë shtetit (të shpërngulur)

Të rinjve që janë shpërngulur nga shteti ynë u shtruan pyetje të ngjashme. Pyetja e parë ishte: "Cilat ishin për ju arsyet kryesore për shpërngulje?". Në këtë pyetje, pothuajse të gjithë bashkëbiseduesit u përgjigjën se mundësitë më të mëdha dhe më të mira për arsimim dhe avancim në karrierë janë arsyet kryesore pse u shpërngulën nga shteti. Por, gjithashtu, edhe kultura të ndryshme, njohja e dallimeve etj.

Në pyetjen: "A u plotësuan pritjet tuaja në lidhje me atë që e keni dëshiruar t'a arrini me shpërnguljen?" 100% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht.

Të rinjve, gjithashtu, ua shtruan edhe këtë pyetje: "Në çka ju asocion të jetosh në shtetin tonë?" Në përgjigjet e kësaj pyetjeje, mbizotëron fjala "çrregullim", ndërsa përveç mosfunksionalitetit, stresit, tollovisë, korrupsionit, mungesës së mundësive dhe paaftësisë, këta të rinj, gjithashtu, shteti ynë i asocion edhe me argëtimin, familjen, shoqërinë dhe shtëpinë.

E shtruar edhe pyetjen: "Në çka ju asocon jetesa në vendin ku jeni aktualisht?", të rinjtë që jetojnë jashtë vendit u përgjigjën se të jetuarit në shtetin ku ndodhen aktualisht, i kujton "në gjithçka që është në kundërshtim me përgjigjet në pyetjen paraprake", saktësia, preciziteti, siguria më e madhe, mundësi më të mëdha, etj. Për të mësuar gjithashtu edhe për impaktin nga shpërngulja, e shtruar pyetjen: "Si ndikoi shpërngulja tek ju personalisht?". Të gjitha përgjigjet fillojnë me aspekte pozitive siç janë - mundësi të reja, pamje të reja të botës, rahatia, të mësuarit, përmirësimi dhe të ngjashme. Ndërsa nga pasojat negative, të rinjtë i veçojnë - largësia nga familja, përvoja traumatike gjatë adaptimit, etj.

Këtë grup të rinjsh, ndryshe nga grupi i mëparshëm, i sfiduar që t'a përfundojnë fjalinë "Unë do të kthehesha për të jetuar në shtetin tonë nëse...". Përgjigjet që i kemi marrë janë:

„ në vendin tonë janë arritur standardet perëndimore socio-ekonomike të jetesës

„ do të funksiononin ligjet dhe institucionet, do të hapeshin më shumë perspektiva për punë, do të zgjidheshin problemet që lihen pas dore, do të përmirësohet cilësia e jetës dhe nëse do të ktheheshin të gjithë miqtë e mi për të jetuar atje”.

„ “ sistemi funksionon sipas rregullave të dispozitave dhe është i shpejtë”.

„ rregullohet situata politike, juridike, shëndetësore dhe ekonomike. Nëse zvogëlohet ndotja (dytësore, sepse mund të jetohet edhe jashtë qytetit) dhe nëse punëdhënësi i ri më ofron kushte më të mira për punë dhe një pagë përkatëse”.

„ procesi i globalizmit ka prekur cepin tonë të botës”.


„ ndryshon mendësia e përgjithshme e njerëzve, gjë që është e pamundur, dhe nëse më ofrohet një punë që do të paguhet mirë dhe do t'i përshtatet profilit tim”.

Pyetja tjetër që e shtruar ishte: "A keni menduar që të ktheheni në Maqedoni dhe a ka ndonjë gjë që mungon për të ndërmarre një hap të tillë?". Nga gjithsej 6 të rinj të anketuar, tre u përgjigjën se po mendonin të ktheheshin në vendin tonë, por jo shumë shpejt, pasi që arsyet që e kanë braktisur shtetin akoma janë të pranishme. Nëse situata ndryshon në të ardhmen, ata do të kthehen. Ndërsa tre të rinj të tjerë, në këtë pyetje u përgjigjën se, megjithatë, nuk mendojnë për t'u rikthyer në shtetin tonë, për të njëjtat arsye. Disa prej tyre u përgjigjën se po mendonin të largohen nga vendi në të cilin ndodhen aktualisht, por jo edhe të kthehen në Maqedoni. Sidoqoftë, nëse kushtet ndryshojnë në të ardhmen, të gjithë të rinjtë e anketuar pajtohen se ata do të mendonin për t'u rikthyer në shtetin tonë.

Ky grup i të rinjve, gjithashtu, u përgjigjën edhe në pyetjen se cilat janë arsyet jo-ekonomike që kontribuan në vendimin e tyre, kurse në përgjigjet mbizotërojnë të drejtat e punës, mundësitë për zhvillimin dhe përmirësimin personal, ndjenja e pa-shpresës, arsimit, mjedisi, kultura, siguria dhe shëndetësia.


Pyetësi anketues - personat që jetojnë jashtë vendit

Në pyetësin anketues në pjesën ku përgjigjen personat që janë shpërngulur nga shteti, përveç faktorit ekonomik, të anketuarit përgjigjen edhe për atë se cilat janë arsytet e tjera pse janë shpërngulur. 5 arsytet kryesore me më shumë përgjigje janë:



Në pyetjen: "Në një shkallë prej 1 deri në 5 sa u përmbushën pritjet tuaja në lidhje me atë që keni dëshiruar të arrihet me shpërnguljen?", nga gjithsej 56 të anketuarit, 29 u përgjigjën me 5, ose se janë përmbushur plotësisht pritjet e tyre, 22 të anketuarit janë përgjigjur me 4, 4 janë përgjigjur me 3 dhe 1 i anketuar me 1, ose se pritjet e tyre nuk janë përmbushur fare.

Përmbushja e pritjeve të të rinjve nga shpërngulja (1 nuk janë përmbushur - 5 tërësisht janë përmbushur)



Në pyetjen: "A keni menduar për rikthimin e përhershëm në Maqedoninë e Veriut?", nga gjithsej 56 të anketuarit, 28 u përgjigjën se nuk mendojnë që të kthehen, 20 të anketuarit u përgjigjën se ndonjëherë mendojnë të kthehen në vendin e lindjes dhe 8 të anketuarit janë përgjigjur se po mendojnë të kthehen mbrapa.

Të menduarit rreth kthimit të përhershëm në Maqedoni

4 Hganjëherë

7 Jo

28 Po

Yetëtori anketues - personat që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Kësaj kategorie të personave ua shtruum pyetjen: "A planifikoni që t'a braktisni shtetin?". Nga gjithsej 1.134 përgjigje, 696 persona janë përgjigjur me PO, 89 persona janë përgjigjur me JO, kurse 349 persona janë përgjigjur me NUK DI.

Të menduarit e të rinjve për braktisjen e shtetit në të ardhmen



Në vazhdim, personat i pyetëm se cilat arsye do t'i numrojnë për shpërnguljen e tyre. Përveç arsyeve financiare, këto janë 5 arsyet që morën vëmendjen më të madhe nga të anketuarit:

- 1 Situata politike në vend;
- 2 Mjedisi
- 3 Shëndetësia
- 4 Zhvillimi i karrierës
- 5 Të drejtat e njeriut



МРЕЖА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ
ОДЛИВ НА МОЗОЦИ



ПРОЦЕС